



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës:	2021:093332
Datë:	26.04.2022
Numri i dosjes:	2021:093333

C.nr.987/21

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Burim Emërllahu, në çështjen kontestuese të paditësit Rr.M ,nga Fshati Komuna e Ferizajit ,të cilin në bazë të autorizimit e përfaqëson avokati Besmir Rrahmani nga Ferizajit, kundër të paditurës Kompania Rajonale e Ujësjetllësit ‘‘B...’’Sh.A Ferizaj , të cilën në bazë të autorizimit e përfaqëson B.A, baza juridike pagesa përcjellse në pension dhe shpërblimit jubilar, me datë 26.04.2022 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I.PJESËRISHTË APROVOHET SI E BAZUAR kërkesëpadi e paditësit Rr.M, dhe **DETYROHET** e paditura Kompania Rajonale e Ujësjetllësit ‘‘B...’’Sh.A Ferizaj ,që paditësit Rr.M, t’ia paguaj në emër të shpërblimit jubilar për 20 vite të përvojës në punë te e paditura shumën prej 766.1 euro,me me kamatë ligjore prej 8 % duke llogaritur nga data e paraqitjes së padis data 18.05.2021 e deri në pagesen definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e plotëfuqieshmërisë së këtij aktgjykimi.

II.REFUZOHE T SI E PA BAZUAR pjesa e kërkespadi së paditësit Rr.M, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura Kompania Rajonale e Ujësjetllësit ‘‘B...’’Sh.A Ferizaj që paditësit Rr.M , t’ia paguaj në emër të shpërblimit jubilar shumë të prej 383.05 euro,në emër të pagave përcjellse shumë të prej 1149.15 euro, me kamatë ligjore prej 8 % duke llogaritur nga data e paraqitjes së padis e deri në pagesen definitive.

III.Detyrohet e paditura Kompania Rajonale e Ujësjetllësit ‘‘B...’’Sh.A Ferizaj që paditësit Rr.M në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore tja paguaj shumë siq vijon:për përfaqësim në një seancë gjyqësore shumë të prej 135.20 euro,për hartimin e padis 104 euro,për taksën për padi 20 euro ,të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e plotëfuqieshmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Paditësi Rr.M, ka parashtruar me padi në këtë Gjykatë, kundër të paditurës Kompania Rajonale e Ujësjetllësit ‘‘B...’’Sh.A Ferizaj me bazë juridike pagesa përcjellse në pension dhe shpërblimit jubilar.

Nga thënjet e paditësit në padi rezulton se paditësi padin e tij e bazon në faktet : se ka qenë në mardhënje pune te e paditura ,në periudhën kohore 15.03.1989 deri me datën 23.03.2021 ,mirëpo e paditura paditësit nuk ia ka paguar shumë siq në dispozitiv të këtij aktgjykimi edhe pse të njëjtat paditësit i takojnë në bazë të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive konkretisht neneve 52 dhe 53.

Përfaqësuesi i paditësit avokati Besmir Rrahmani ,gjatë seancës ka kërkuar që të aprovohet si e bazuar kërkesëpadi e paditësit e specifikuar si në pikën I dhe II të dispozitivit të këtij aktgjykimi si dhe i ka kërkuar shpenzimet e procedurës të specifikuar si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Përfaqësuesi i të paditurës B.A në lidhje me qështjen kontestimore ka theksuar:Padia e paditësit është e paafatshme ,sepse MPKK e nënshkruar ,me datë 18.03.2014 ,me nenin 82 të sajë ka paraparë se hynë në fuqi me dat. 01.05.2015 dhe e njëjta ka qenë në fuqi deri me datën 01.01.2019,ndërsa paditësit i është ndërprerë mardhënja e punës nga data 23.03.2021 ,më shumë se dy vite nga skadimi i MPKK.Pretendimi për të gëzuar te drejtat të cilat rrjedhin nga MPKK ,pas skadimit të qdo afati të paraparë në këtë marrëveshje nuk ka bazë ligjore dhe është në kundërshtim me praktikën ligjore dhe parimet e përgjithshme.Është evidente për arsye të njohura për publikun se MPKK nuk është përtrirë dhe me përfundimin e afatit të paraparë prej 3+1 vitësh,përfundojnë të gjitha obligimet nga ana punëdhënësit në raport me punëtorin.Së fundmi MPKK është një

marrveshje e lidhur ndërmjet Bashkimit të organizatave të punëdhënësve ,bashkimit të organizatave të punëmarrësve si dhe institucioneve shtetërore ,qka nënkupton që për të qenë përfitues i të drejtave të cilat dalin nga kjo marrëveshje ,paditësi duhet të jetë anëtarë i sindikatës së punëtorëve të KRU B... SH.A dhe kjo e fundit anëtare e ndonjëres nga sindikatat amë të cilat janë nënshkruese të kësaj marrëveshje.Kërkojmë që të refuzohet padia e paditësit si e pa bazuar.

Me qëllim të vërtetimit sa më të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje civilo juridike ,gjatë shqyrtimit kryesorë janë administruara si provë:vërtetimi i dt. 21.03.2022, nr. 827 i lëshuar nga e paditura, vendimi i dt. 23.03.2021 nr. 344 i lëshuar nga e paditura,kërkesa e dt. 01.04.2021, e parashtruar nga paditësi te e paditura, vendimi i dt. 02.04.2021, nr. 430 i nxjerrur nga e paditura në lidhje me kërkesën e paditësit, ankesa e dt. 21.04.2021, e parashtruar nga paditësi për të paditurën, listat e pagave për muajin janar 2021, shkurt 2021, mars 2021,Kontrata mbi Themelimin e Mardhënjes së Punës e lidhur ndërmjet palëve,nr.1211,e dates 30.07.2014.

Gjykata provat e administruara i ka vlerësuar sipas nenit 8 të LPK-së dhe ka vërtetuar këtë gjendje faktike :

Me leximin e vendimit ,nr.344,i dates 23.03.2021 i lëshuar nga e paditura gjykata ka vërtetuar se paditësit me këtë aktvendim i është ndërprerë mardhënka e punës me datë 23.03.2021 ,për shkak të arritjes së moshës së pensionimit.

Me leximin e vendimit nr.430,i datës 02.04.2021 ,i lëshuar nga e paditura gjykata ka vërtetuar se me këtë vendim paditësit i është refuzuar kërkesa me të cilën kishte kërkuar nga e paditura pagesën e tri pagave përcjellse pas pensionimit.

Me leximin e listave të pagave për muajin janar,shkurt,mars 2021 gjykata ka vërtetuar se paga neto e paditësit te e paditura ishte 383.05 euro në muaj .

Me leximin e Kontratës mbi Themelimin e Mardhënjes së Punës e lidhur ndërmjet palëve,nr.1211,e dates 30.07.2014,gjykata ka vërtetuar se paditësi kishte themeluar mardhënje pune te e paditura në bazë të kësaj kontrate në vendin e punës ndihmës operatori duke filluar nga data 31.07.2014 ku paga bazë e tij ishte përcaktuar 342 euro në muaj.

Me leximin e vërtetimit nr.827,i datës 21.03.2022 ,i lëshuar nga e paditura gjykata ka vërtetuar se paditësi ka qenë punëtorë i rregullt te e paditura në periudhën kohore 15.03.1989 deri me datën 23.03.2021.

Kurse ndërmjet palëve nuk ishte kontestuese fakti se e paditura paditësit nuk ia ka paguar shumat që i kërkon me kërkesëpadi.

Me nenin 52 paragrafi 1 pika 1.2 të Marrëveshjes së Përgjithëshme Kolektive të Kosovës që ka hyrë në fuqi me datë 01.01.2015 është parapar: se i punësuari, ka të drejtë në shpërblimin jubilar për 20 vjet të përvojës në punë pandërprerë, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të dy paga mujore të tij.

Kjo gjykatë duke u nisur nga dispozitat e nenit 52 të Marrëveshjes së Përgjithëshme Kolektive të Kosovës ,në fuqi nga data 01.01.2015, si dhe gjendjes faktike të shpjeguar më lartë ,ka ncjerrur përfundim se pjesërishtë është e bazuar kërkespadia e paditësit dhe nga kjo arsye edhe e ka detyruar te paditurën që paditësit t’ia paguaj shumën si në pikën I të dispozitiv të këtij aktgjykimi, sepse nga provat e administruara dhe faktet jo kontestuese u vertetuar fakti se paditësi Rr.M, ka qenë në mardhënje pune te e paditura, nga data 15.03.1989 deri me datën 23.03.2021 ,mirëpo e paditura paditësit nuk ia ka paguar shumën e mjeteve monetare si ne piken I të dispozitivit të këtij aktgjykimi edhe pse ka pasur obligim t’ua paguaj në bazë të nenit 52 të Marrëveshjes së Përgjithëshme Kolektive të Kosovës të datës 01.01.2015.

Gjykata ka vlerësuar edhe thënjet e përfaqësuesit të të paditurës i cili e ka kundërshtuar kërkesëpadin duke u bazuar në faktin se Marrëveshja e Përgjithëshme Kolektive e Kosovës nuk është në fuqi,mirëpo kjo gjykatë konsideron se edhe nëse Marrëveshjes së Përgjithëshme Kolektive të Kosovës nuk ka qenë në fuqi në kohën kur është ushtruar padia,gjegjësishtë kur paditësi ka dalur në pension kjo nuk e bën kërkesëpadin e paditësit si në pikën I të pa bazuar,sepse në mardhënjet juridiko civile aplikohen dispozitat juridike ligjore dhe ato kontraktuese që kanë qenë në fuqi në konë kur ka lindur mardhënja juridiko civile ,në këtë rast mardhënja juridiko civile detyrimore ka lindur në vitin 2015 ,kur paditësi ka pasur përvojën 20 vjeqare të punës.

Gjykata e ka refuzuar kërkesëpadin e paditësit si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi që ka të bëj me shpërblimin jubilar nga arsye se në kohën kur paditësi ka arritur moshën 30 vjeqare mars 2019 Marrëveshja e Përgjithëshme Kolektive të Kosovës nuk ka qenë në fuqi prandaj paditësi nuk mund të realizoj të drejtën për pagën e tretë në kohën kur e njejta e marrëveshje nuk ka qenë në fuqi,sepse e njejta pas skadimit të sajë nuk mund të krijoj të drejta për paditësin e as detyrime për të paditurën.

Gjykata e ka refuzuar kërkesëpadin e paditësit si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi që ka të bëj me pagat përcjellëse nga arsye se në kohën kur paditësi ka arritur moshën pensionimit 23.03.2021 Marrëveshja e Përgjithëshme Kolektive të Kosovës nuk ka qenë në fuqi prandaj paditësi nuk mund të realizoj të drejtën për paga përcjellëse kur e njejta e marrëveshje nuk ka qenë në fuqi,sepse e njejta pas skadimit të sajë nuk mund të krijoj të drejta për paditësin e as detyrime për të paditurën.

Baza ligjore e kërkesëpadis së paditësit qëndron edhe në nenin 8 të Ligjit për Mardhënjeve të Detyrimeve, me të cilin është paraparë Pjesëmarrësit në marrëdhënien e detyrimit kanë për detyrë ta përmbushin detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e të njëjtit.

Kurse me nenin 245 paragrafi 1 të LMD-së është paraparë Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij.

Vendimi për kamatën është bazuar në nenin 382 të LMD-së së Kosovës.

Gjykata bazuar në dispozitat e neneve 452.5 454.1, 453 të LPK-së e ka detyruar të paditurën që paditësit t'ia kompenzoj shpenzimet e procedurës të cekura si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Me datë 26.04.2022

Gjyqtari

Burim Emërllahu

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi mund të ushtrohet ankesa, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, përmes kësaj gjykate.